



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

## **Study program Informatikë Biznesi (2017/2018)**

Fakulteti	Shkencat dhe Teknologjitë Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Titulli	Magjistër në Informatikë Biznesi
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-1619/2
Vendimi për fillim me punë	03-1619/16 (10.11.2017)
Data akreditimit	29.06.2017

## **Përshkrimi i programit**

Informatika e biznesit është një disiplinë e njohur gjerësisht në Evropën kontinentale. Edhe pse është e ngjashme me sistemet e informacionit, ajo më shumë fokusohet në çështjet teknike, duke përfshirë këtu sistemet informatike dhe qasjet strukturore për modelimin dhe analizimin e proceseve të biznesit dhe problemet lidhur me to.

Informatika e biznesit është veçanërisht e rëndësishme në fushën e ekonomisë dhe mjedisit ndërmarrës. Ajo karakterizohet me bashkimet strategjike, outsourcing, mjedise operative të shpërndara fizikisht dhe partneritete globale të biznesit. Objektivi kryesor i këtij programi do të jenë strategjitë e reja, teknikat, mjetet dhe teknologjitë për zhvillimin e një fushe të përshtatshme si informatika e biznesit.

Kuptimi i biznesit dhe informatikës është e një rëndësie të madhe për punën e të gjithë profesionistëve të biznesit, duke përfshirë këtu edhe menaxherët ekzekutivë të cilët e përcaktojnë drejtimin strategjik të organizatës, profesionistët e informacionit që hartojnë dhe ofrojnë shërbime të reja të informacionit; kontabiliteti dhe menaxherët financiarë të cilët përdorin sistemet e informacionit për menaxhimin e financave dhe krijimin e raporteve të biznesit dhe menaxherët e marketingut e të shitjes të cilët përdorin sistemet e informacionit për të ndjekur blerjen e konsumatorit dhe për të promovuar produkte të reja.

Informatika e biznesit është studim i teknologjisë së informacionit në kontekstin e biznesit. Informacioni është bërë burim kyç i biznesit që çon në krijimin e karrierave të reja për individët të cilët e kuptojnë se si të veprojnë me informacionin. Këta "punëtorë të ditur" - njerëz të cilët e kuptojnë si ta ruajnë, ta rimarrin, ta analizojë dhe ta shpërndajnë informacionin - aktualisht kanë një karrierë premtuese dhe produktive e cila është e cila i pret ata.

Kjo baraspeshë, gjithashtu, pasqyron lidhjen ndërmjet përmbytjes teorike dhe praktike të lëndëve të fituara përmes ligjëratave, udhëzimeve, seminareve, sesioneve në laboratorë kompjuterikë dhe vetëstudim. Njohuritë nga lëndët fitohen përmes metodave të ndryshme të përafrimit duke përfshirë sesionet e provimit, testet në klasë, ato tutoriale, detyrat individuale, punën në grup dhe prezantimet. Studentët pritet të demonstrojnë aspekte të origjinalitetit dhe të shpikjes.

Objektivi i programit është që t'i pajisë studentët me përvoja cilësore të studimit të cilat do t'u ofrojnë atyre mundësitë më të mira për të kuptuar fushat e mbuluara dhe ta kuptojnë potencialin e tyre maksimal.

Të gjithë mësimdhënësit në fakultetin tonë janë profesionistë shumë të respektuar të cilët mbeten aktivë në fushat e tyre dhe mbajnë kontakte personale në rajon dhe rrethinë. Një program i projektuar për cilësi gjithashtu është mbajtur dhe në të mësimi përfshin përvojat reale botërore, punën praktike dhe bashkëpunimin me kompanitë e suksesshme në fushën e biznesit gjë që mund të çojë në punësim të shpejtë.

## **Karriera**

With the Master of Science in Business Informatics, the graduates will find employment in the fields of system development, software project management, ultimate users of IT support, programming, and as business system analysts, system analysts. For this reason, the individuals who have not only the ability to design technical, computer-based solutions, but also have the ability to notice the possibilities of IT from a business perspective, will be sought for employment by every organization. Students will be equipped with the following skills:

- To manage information function in middle-size and big organizations
- To analyze, plan and develop IT solutions which support the market needs.
- To plan the required business analysis and business risk estimates.
- To develop skillfulness, to contribute in the decision making, design and implementation of the changes in the business process.

## **Rezultatet e të mësuarit**

### **Njohuritë dhe të kuptuarit**

- Njohuritë dhe të kuptuarit e fushave të biznesit dhe të informatikës (ekonomi, menaxhim, marketing, financa dhe përkatësisht, programim, bazat e të dhënave, sistemet kompjuterike dhe të informacionit, rrjetet dhe inxhinieria e të dhënave) në një nivel që shtrihet përtej njohurive themelore përmes njohurive elementare të orientuara në hulumtime dhe aftësi për të demonstruar ekspertizë në trajtimin e problemeve të botës reale në këtë fushë.
- Aftësi për të zhvilluar dhe zbatuar ide origjinale dhe kreative në një mjedis që kërkon njohuri ndërdisiplinore, fusha të ndërlidhura të biznesit dhe informatikës dhe të tregojë kompetenca specialiste në të njëjtën mënyrë.

### **Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit**

- Në mënyrë origjinale, kritike, të pavarur dhe krijuese mund të zbatojë, të përdorë, të zhvillojë dhe të zgjidhë probleme në mjedise të reja dhe të panjohura në një kontekst shumëdisiplinor të një biznesi të vërtetë dhe në mjediset organizative.
- Mund të planifikojë, të zbatojë dhe t'i vlerësojë çështjet e pavarura kërkimore në fushën e biznesit duke zbatuar metoda dhe metodologji të ndryshme të zhvillimit të softuerit në bizneset komerciale.
- Mund të përdorë një shumëllojshmëri të mjeteve të zhvillimit të softuerit dhe t'i programojë ato duke përdorur skripte shell dhe programe të hartuara për mjedise ueb ose programe të pavarura.
- Në mënyrë origjinale, kritike dhe krijuese mund të marrë pjesë në procesin e zgjidhjes së problemeve në mjedise të reja, të papara ose të panjohura për zhvillimin e softuerit.
- Është në gjendje t'i organizojë sistemet softuerike në mënyrë që të zgjidhë çështje të ndryshme sociale, ekonomike dhe/ose teknologjike.
- Është në gjendje të marrë pjesë në projekte kërkimore si një bazë për zhvillimin e mëtejshëm akademik.
- Demonstron ekspertizë në trajtimin e problemeve reale në fushën e zhvillimit të softuerit dhe të menaxhimit të projekteve.
- Mund të zhvillojë dhe të aplikojë ide origjinale dhe krijuese. Demonstron ekspertizë në trajtimin e problemeve reale në fushën e zhvillimit të softuerit dhe menaxhimit të projekteve.
- Mund të zhvillojë dhe aplikojë ide origjinale dhe krijuese.

### **Aftësitë për të vlerësuar**

- Në mënyrë adekuate mund të mbledhë, të analizojë dhe të vlerësojë të dhënat duke përdorur mjete dhe sisteme moderne për çështje të caktuara ekonomike dhe/ose informative dhe organizative, zakonisht nga perspektiva e menaxhimit dhe marketingut.
- Mund të argumentojë ide dhe koncepte cilësore dhe sasiore me karakter biznesi dhe organizativ duke përdorur dhe duke zbatuar njohuritë e sistemeve të informacionit, bazave të të dhënave të korporatave dhe mjete të tjera softuerike.
- Ka aftësi që në mënyrë adekuate të vlerësojë afatet e kërkuara, burimet dhe rreziqet në planifikimin, zhvillimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e softuerit, duke përdorur mjetet e duhura.
- Mund të testojë, të vlerësojë dhe të vendosë mbi përshtatshmërinë e IT zgjidhjeve të mundshme në perspektivë komerciale.

### **Aftësitë e komunikimit**

- Ka aftësi që në mënyrë të qartë dhe pa ambiguitet t'u komunikojë rezultatet dhe njohuritë e studimit audiencave të specializuara nga fushat e biznesit dhe informatikës me shkathësinë për ta përshtatur stilin dhe formën e të shprehurit për audiencë jo-specialiste.
- Ka kompetenca për të kryer hulumtime në mënyrë kritike, krijuese, të pavarur dhe të argumentuar dhe për të vlerësuar metodologjitë dhe për të zhvilluar kritikën kur duhet të propozojë dhe të mbrojë hipoteza të reja.
- Mund të demonstrojë aftësi për inicim, duke udhëhequr dhe duke marrë përgjegjësinë për një punë individuale dhe

grupore, ku kompetencat e biznesit dhe informatikës janë vendimtare për llojin e pozitës.

### **Aftësitë e të mësuarit**

- Është në gjendje t'i identifikojë nevojat personale dhe drejtimet për studimin individual dhe autonom siç mund ta kryejë atë në mënyrë të vetë-drejtuar dhe autonome në fushat e biznesit dhe informatikës.
- Është në gjendje të marrë përgjegjësi për të mësuarit e vazhdueshëm individual dhe atë në grup, në fusha të specializuara të biznesit dhe të informatikës brenda ekonomisë në rrjet, duke përfshirë këtu edhe përcaktimin e objektivave të të nxënit afatmesëm dhe afatgjatë.

## **Lista e lëndëve**

### **Semestri 1**

- [MCBI-01] [6.0 SETK] **Modelimi i proceseve të biznesit**
- [EMBI1030] [6.0 SETK] **E-kontabilitet**
- [ECSIS-05] [6.0 SETK] **Menaxhimi i sistemeve të informacionit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### **Semestri 2**

- [MCBI2021] [6.0 SETK] **E-tregtia**
- [SAD0102] [6.0 SETK] **Inxhinieria softuerike**
- [MCBI2022] [6.0 SETK] **Menaxhimi me projektet e TIK**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### **Semestri 3**

- [MCBI3031] [6.0 SETK] **Inteligjenca e biznesit dhe analitika**
- [ECSIS-07] [6.0 SETK] **Analiza dhe dizajnimi i sistemeve**
- [EMCS-01] [6.0 SETK] **Arkitekturat e orientuara në shërbime**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### **Semestri 4**

- [MCBI4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

## **Description of courses**

### **Lëndë obligative**

- **Modelimi i proceseve të biznesit**

Qëllimet e lëndës janë: Proceset janë teknologjitë kryesore të të gjitha organizatave për prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve që kënaqin nevojat e konsumatorëve. Gjithnjë e më shumë, në mënyrë që të vazhdojë të ju shërbejnë klientëve të tyre dhe të mbeten konkurrues, organizatat duhet të vazhdimisht të analizojnë, ridizajnojnë, dhe të përmirësojnë proceset e tyre të biznesit në kohë më të shkurtër për të arritur qëllimet operacionale. Duke kuptuar këtë, procesi i integritit të biznesit kërkon një infrastrukturë IT që mundëson njerëzit, proceset dhe informacione të integrohet në mënyrë fleksibile. Ky kurs do të shqyrtojë se si organizatat mund të modelojnë proceset e biznesit, si hap i parë në arritjen e proceseve fleksibile dhe të integruar të biznesit. Kursi do të shqyrtojë teknologjitë e informacionit dhe arkitekturat që premtajn për të bërë të mundur këtë integrim të biznes procesëve. Kursi do të pajisë studentët me: - Një kornizë për të kuptuar projektimin, kontrollin dhe përmirësimin e proceseve të biznesit. Pjesa më e madhe e këtij materiali do të jetë nga fusha e menaxhimit të operacioneve. - Një metodologji për të analizuar, modeluar dhe dizajnuar biznes procese, duke përfshirë përdorimin e simulimit për matjen dhe krahasimin e performancës së modeleve të ndryshme. - Njohja e teknologjive aktuale në zhvillimin e sistemeve të informacionit dhe arkitekturave si fasilitatorët e përmirësimit, integritit dhe automatizimit të procesit të biznesit biznes proceseve.

- **E-kontabilitet**

Lënda synon të analizojë prizmin e kontabilitetit në sistemet e informacionit. Lënda gjithashtu analizon kontabilitetin nga perspektiva e biznesit dhe nga perspektiva e sistemit. Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë proceset e brendshme në kontabilitet, si këto procese janë të lidhura, çfarë efekti ka çdo proces në procese të tjera, llogaritë dhe raportet vjetore. Këto njohuri studentët do të mund t'i përdorin në karrierën e tyre si analistë të biznesit.

- **Menaxhimi i sistemeve të informacionit**

Qëllimi i lëndës është të japë hyrje më të zgjeruar në sistemet e informacionit nga aspekti organizativ dhe prizma shoqërore. Qëllimi është që t'i ushqejë studentët me balancë adekuate nga teknikat dhe perspektivat organizative, të cilat do të shfrytëzohen si bazë për studime të mëtutjeshme në këtë fushë studimi.

- **E-tregtia**

Transaksionet tregtare në një epokë elektronike, të kuptuarit e teknologjisë, të transaksioneve, të marketingut dhe tregtisë, biznesit, menaxhimit dhe teknikave të implementimit të e-tregtisë. Studentët do të fitojnë aftësitë e udhëheqjes, të planifikimit dhe menaxhimit me ekipe të përfshira në iniciimin dhe zhvillimin e projekteve të teknologjisë së lartë.

- **Inxhinieria softuerike**

Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me njohuri dhe të kuptuarit e koncepteve të në inxhinierinë softuerike. Duke filluar nga specifikacionet formale, cilat notacione, simbole dhe specifikime ("metoda formale") janë të nevojshme për të përcaktuar një sistem formal softuerik? Studentët do të njihen me ndërtimin e një specifikimi të qartë formal. Ajo gjithashtu synon të trajtojë aspektet e inxhinierisë softuerike të avancuar: cilat janë aktivitetet kryesore teknike të kryera gjatë procesit të zhvillimit të procesit softuerik? Çfarë inxhinieri softuerike të bazuar në komponentë është përdorur për të krijuar sisteme me komponentë të përdorshëm? Si realizohet një klient / server arkitekturë të ndikojë në mënyrën e softuerit që është zhvilluar? A janë konceptet dhe parimet e inxhinierisë softuerike të aplikueshme për aplikacionet të bazuara në ueb dhe produkte në ueb?

- **Menaxhimi me projektet e TIK**

Lënda ofron një hyrje në fushën e menaxhimit të projekteve të TIK, teknikat e prezentimit dhe qasjet me qëllim të zhvillimit të vetedijes kritike për sfidat dhe mangësitë në këto fushë. Ky modul bazohet mbi njohuritë nga fusha e inxhinierisë softuerike si dhe kurseve tjera që lidhen me sistemet e informacionit.

- **Inteligjenca e biznesit dhe analitika**

Qëllimi i lëndës është që të ju sigurojë studentëve një kuptim të disa teknikave të shkencës së menaxhimit dhe të ofrojë disa njohuri se si këto mjete mund të përdoren për të analizuar problemet komplekse të biznesit dhe të arrijnë në një zgjidhje racionale. Teknikat për të studiuar përfshijnë parashikimin, planifikimin linear, simulimin, dhe modelimin. Rastet e kompleksitetit në rritje do të përdoren për të theksuar përshkrimin e problemit, përkufizimin, dhe formulimin. Kompjuteri do të përdoret gjerësisht në të gjithë kursin, kryesisht duke përdorur programe në dispozicion për të kryer llogaritjet pasi problemi është formuluar si duhet. Theksi do të vendoset në interpretimin dhe zbatimin e rezultateve. Përveç kësaj, ne do të shqyrtojmë të ardhmen e analitikës.

- **Analiza dhe dizajni i sistemeve**

Qëllimi i lëndës është që studentët të kuptojnë dhe të përdorin metodologjitë, teknikat, mjetet dhe perspektivat thelbësore për analistët e sistemeve që të hetohen dhe të zhvillohen me sukses kërkesat e sistemeve të informacionit, si dhe të jepen zgjidhje të përshtatura për kërkesat duke përdorur teknika standarde të modelimit të tilla si teknikat e strukturuar të modelimit, teknikat e modelimit të inxhinierisë informatike dhe teknikat e modelimit të objekteve. Për më tepër, të kuptohen metodat dhe kufizimet e përfshira në krijimin e një dizajni të realizueshëm nga rezultatet e përdorimit të analitikës së sistemeve të përmendura më sipër.

- **Arkitekturat e orientuara në shërbime**

Qëllimi i lëndës është që të ofrojë një studim më të thellë të Arkitekturave të Orientuara në Shërbime (SOA) nga tri këndvështrime kryesore: biznes perspektiva, perspektiva arkitektonike dhe këndvështrimi teknologjik. Nga perspektiva e biznesit, adaptimi i SOA është thelbësor në sigurinë e zhdërvjelltësisë së biznesit, prandaj rëndësia e SOA në industri do të shpjegohet. Perspektiva arkitektonike do të trajtojë modele të ndryshme arkitekturore të zhvillimit të softuerit, me fokus të veçantë në atë të projektimit të SOAs dhe të projektimit të modeleve në SOA. Nga perspektiva teknologjike, studentët do të kenë mundësinë të fitojnë përvojën e nevojshme për të implementuar dhe për të zbatuar zgjidhje të ndryshme SOA që plotësojnë kërkesat funksionale dhe jo - funksionale.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve që të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe për të bërë detyrën më të ndërlikuar - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët t'i fitojnë njohuritë e nevojshme, por edhe aftësitë dhe shkathtësitë që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe stilit të shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, siç janë: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

## Lëndë zgjedhore

- **Inxhinieringu i dijes**

Njohuritë e përfshira në World Wide Web janë në dispozicion përmes dokumenteve të ndërlidhura dhe të shkruara në gjuhë natyrale. Për të shfrytëzuar këta njohuri nevojiten zbatimi i teknologjive të tilla si përpunimi i gjuhës natyrale, gjetja e informacionit dhe eksplorimi (minimi) i njohurive. Teknologjitë e Uebit Semantik ndjekin një qasje alternative duke plotësuar ueb dokumentet me semantikë eksplicite të bazuara në reprezentimin formal të njohurisë (dijes), të tilla si ontologjitë. Qëllimi i këtij kursi është që të mësohen bazat e teknologjive të uebit semantik dhe se si zbatohen ato për paraqitjen e njohurive në World Wide Web. Studentët do të marrin dije mbi atë se si të paraqiten njohuritë përmes ontologjive dhe se si të përfitojnë nga të dhënat semantike në Ueb. Për më tepër, fokusi do të jetë se si ta bëjnë përdorimin e të dhënave me karakter të hapur në Ueb (linked Open Data), e cila paraqet aktualisht aplikimin më të njohur të bazuar në teknologjitë e Uebit semantik.

- **Gjurmimi i të dhënave nga Ueb për inteligjencë biznesi**

Studim i avancuar i procesit të zbulimit dhe diturive si dhe aplikimet e tyre në gjurmimet në Ueb, analitikë të Ueb-it dhe inteligjencë biznesi. Kjo lëndë mbulon aspektet e ndryshme të grumbullimit të të dhënave dhe procesin e para-përpunimit të të dhënave si dhe teknikat themelore të gjurmimit të të dhënave për segmentim, klasifikim, modelime parashikuese, analizë asociacioni dhe gjurmimet e ngjashmërive sekuenciale. Fokusi kryesor i lëndës është në aplikimin e këtyre teknologjive në analitikën e Ueb-it, modelimin e sjelljes së shfrytëzuesit, e-metrikën për biznes inteligjencë, Ueb personalizimin dhe sistemet e rekomandimit. Gjithashtu adresohen edhe privatësia dhe çështjet etike të ndërlidhura me gjurmimin e të dhënave në Ueb. Theksi i lëndës do të jetë grumbullimi i të dhënave dhe përdorimi praktik i tyre.

- **Gjurmimi i të dhënave**

“Data Mining” është një nga fushat më aktuale në shkencat kompjuterike. Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njoftohen me metodat e avancuara për përpunim të të dhënave në sasi të mëdha, si në teori ashtu dhe në zbatim praktik. Gjithashtu studentët do të mësojnë ta vlerësojnë dhe ta krahasojnë përshtatshmërinë, zgjerueshmërinë dhe efikasitetin e metodave të ndryshme të aplikuara në “Data Mining”. Lënda në fjalë do të përfshijë dhe tema si: të përpunuarit e të dhënave në shkallë të gjerë, kërkimi në bazë të ngjashmërisë, përpunimi i të dhënave nga rrjetet sociale, përpunimi i të dhënave nga bazat relacionale të të dhënave si dhe metodat për faktorizim të matricave në “Data Mining”. , рударство на податочни потоци, рударство на социјални мрежи и методи на

- **Programimi i bazave të të dhënave**

Bazat e të dhënave praktikisht mundësojnë ruajtjen e një sasi të madhe të të dhënave, duke mundësuar rregullimin (renditjen), gjurmimin, leximin dhe përpunimin në përputhshmëri me biznes kërkesat dhe qëllimet. Lënda është dizajnuar që të zhvillojë shkathtësitë në SQL programim. Theksi është vënë në përkufizimin e të dhënave, manipulimin me të dhëna, kontrollin e të dhënave, si dhe prodhimin e raporteve. Këtu përfshihet gjuha SQL dhe gjuha strukturale për përzgjedhës (PL / SQL). Do të shfrytëzohen veglat zhvilluese Oracle Application Developer për krijimin e bazave të të dhënave dhe për manipulim me të dhënat nga baza e të dhënave (në sistemin për udhëheqje me bazat e të dhënave Oracle). Në kapitujt që do të trajtohen janë përfshirë SQL gjuha për përkufizimin e bazave të të dhënave dhe manipulimin me të dhënat, procedurat e ruajtura, alarmuesit (triggers), teknikat e indeksimit dhe optimizimi i përzgjedhësve themelor.

- **Vizualizimi i të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i përgatisë studentët me shkathtësi elementare dhe të avancuara nga fusha e vizualizimit të të dhënave. Studentët do t'i mësojnë parimet e dizajnit dhe vlerësimit të vizualizimit, do të mësojnë si të mbledhin sasi të mëdha të të dhënave, t'i përgatisin dhe t'i analizojnë këto. Për më tepër studentët do t'i mësojnë teknikat e vizualizimit të të dhënave me shumë dimensione, të dhëna kohore, tekstuale, gjeospaciale, hierarkike si dhe rrjetat / grafet. Studentët do të përdorin vegla siç janë Processing, D3, R dhe ggplot2 si dhe shumë vegla të tjera

që do të ndihmojnë në krijimin e prototipeve nga teknikat e mësuara për vizualizimin e të dhënave ekzistuese.

- **Ueb inxhinieringu**

Ueb-i paraqet platformë të madhe të ofrimit të burimeve. Objektivi i këtij kursi është që t'i trajtojë konceptet, metodat, teknologjitë dhe teknikat për zhvillimin e ueb aplikacioneve me cilësi të lartë, të besueshme dhe të përdorshme. Kursi shqyrton qasjet, metodologjitë, teknikat dhe mjetet që mbështesin projektimin e tyre, zhvillimin, evolucionin dhe vlerësimin e këtyre aplikacioneve. Studentët do të jenë në gjendje të mësojnë metodat Ueb inxhinieringut dhe teknikat që përfshijnë aspektet unike të fushës së problemeve të tilla si: krijimi i dokumentacionit, granulariteti - imët në ciklin e zhvillimit, në zhvillimin e orientuar kah përdoruesit, integrimin klient-server të sistemeve dhe nivelet e ndryshme të aftësive për përdoruesit e fundit, që sigurojnë operacionet e duhura, mirëmbajtjen dhe sigurinë e një aplikacioni për Ueb.

- **Zvillimi i softuerit për njësi mobile**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri dhe të kuptuarit e procesit pragmatik për krijimin e aplikacioneve për pajisjet mobile. Lënda do t'i mbulojë aspektet e zhvillimit të pajisjeve mobile dhe punën individuale praktike të projekteve në hartimin dhe zhvillimin që synon në raste reale praktike një ose më tepër platforma moderne që do t'u mundësojnë studentëve të fitojnë përvojë praktike nga puna e projekteve praktike nga jeta reale.

- **Teknologjitë e kalkulimeve në "Cloud"**

Kjo lëndë mbulon një sërë të teknologjive të fundit nga lëmi i "cloud computing". Studentët do të mësojnë se si të zhvillojnë aplikacione softuerike të bazuara në teknologjitë dhe platformat e ndryshme në Cloud. Gjithashtu do të shpjegohen mënyrat e integrit të shërbimeve në nivel të aplikacioneve të ndërtuara në Cloud platforma heterogjene, si dhe mënyrat e përdorimit të solucionave "Platforma - si- shërbim" dhe "softuerët - si - shërbim" me qëllim të ndërtimit të aplikacioneve të biznesit në Cloud. Për shtresa të ndryshme të cloud teknologjive, zgjidhjet praktike si Google, Amazon, Microsoft, Salesforce.com, etj. do të përdoren kurse aspekti teorik do të mbulohet duke përpunuar botime të hulumtimeve në këtë drejtim.

- **Menaxhimi i projekteve të softuerit**

Qëllimi i kësaj lënde është t'u japë studentëve njohuri për mënyrën se si zhvillohet plani për menaxhimin e projekteve të softuerit për sisteme intensive softuerike; si të ngrihen mekanizma të monitorimit dhe të kontrollit; si të ndahen dhe të rivendosen burimet e projektit, si të ndiqet orari, buxheti, cilësia, produktiviteti dhe progresi; gjithashtu korniza se si të planifikohet për fazën e instalimit dhe përkrahjes të ciklit jetësor të projektit. Ato njëherësh e kuptojnë rëndësinë e strukturës së projektit, planifikimin e burimeve dhe ekzekutimin, si dhe instrumentet e matjes së progresit. Përveç kësaj, ata do të kuptojnë raportet në mes sigurimit të cilësisë, menaxhimit të konfigurimit, verifikimit dhe validimit e testit dhe përcaktimit të vlerës. Njëherësh ata do të kenë kuptim për çështjet kyçe në llogaritjen dhe përcaktimin e çmimit për njësi pune, motivimin e punëtorëve, udhëheqjen e ekipit të projektit dhe menaxhimin e cilësisë në përgjithësi.

- **Testimi dhe analiza e softuerit**

Softueri luan një rol të rëndësishëm në aktivitetet tona të përditshme, shpesh duke u siguruar shërbime kritike përdoruesve finalë. Është e rëndësishme që të sigurohemi që këto sisteme të funksionojnë sipas qëllimit, me nivel të lartë të cilësisë. Testimi dhe analiza e programeve janë dy teknika që përdoren për të siguruar cilësinë e softuerit. Këto teknika përdoren nga ana e zhvilluesve me qëllim që të vërtetohet, kontrollohet dhe vlerësohet cilësia e softuerit të prodhuar gjatë procesit të inxhinierisë softuerike. Kjo lëndë ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë njohuri të avancuara të teknikave që përdoren për testimin e softuerit dhe analizën e programeve. Studentët do të fitojnë njohuri mbi konceptet dhe teoritë që ndodhen pas këtyre teknikave. Gjithashtu, studentët do të mësojnë të përdorin mjetet e njohura ekzistuese që përkrahin detyrat e testimit dhe analizës dhe do të përballen me hulumtimet e reja në këtë fushë.

- **Inxhinieria e kërkesave**

Kjo lëndë mbulon konceptet e krijimit, përkufizimit dhe menaxhimit sistematik me kërkesat e softuerit për sistemet e mëdha, komplekse, të ndryshueshme ku dominon pjesa softuerike. Procesi mbulohet nga ana teknike, organizative si dhe nga perspektiva e menaxhimit, duke diskutuar paradigmat dhe metodologjitë e inxhinierisë së kërkesave që janë përdorur në të kaluarën, përdoren tash ose do të përdoren në të ardhmen. Këtu mbulohen qasjet informate, gjysmë-formale dhe formale, duke mbajtur baraspeshën ndërmjet teorisë dhe praktikës. Kjo nënkupton ndërtimin e modeleve njëherësh edhe të procesit të inxhinierisë së kërkesave edhe të produktit që është rezultat i këtij procesi, në lidhje me qëllimet/kërkesat/specifikimet funksionale dhe jo-funksionale, me përdorimin e një procesi sistematik të vendimmarrjes.

- **Sigurimi i cilësisë së softuerit dhe menaxhimi me rreziqet**

Me rritjen e kompleksitetit të softuerit, dhe më qëllim të sigurimit të kualitetit më të lartë, duhet të përcaktohen procese dhe metodologji të qarta. Me këtë do të sigurohet se produkti përfundimtar ka kaluar nëpër teknika dhe procedura intensive dhe rigorozë të verifikimit dhe validimit. Për më tepër, është e nevojshme të bëhet një menaxhimi i mirë i rreziqeve me qëllim që të sigurohen procese më të sigurta. Kjo shndërrohet në një nivel më të lartë të sigurisë që sistemi softuerik do të kalojë testin e korrektesisë dhe të besueshmërisë. Qëllimi i kësaj lënde është që të ofrojë njohuri teorike dhe praktike mbi procesin e sigurimit të cilësisë dhe menaxhimit me rreziqet.

- **Strategjia e TI-së**

Objektivi i përgjithshëm i lëndës është të zhvillojë të kuptuarit e studentëve për çështjet kyçe të udhëheqjes së TI-së si dhe "praktikat më të mira" për menaxhimin e TI-së. Qëllimi i këtij kursi është t'i ndihmojë nxënësit që në mënyrë të suksesshme të ballafaqohen me menaxhimin e sfidave në TI gjatë rrugëtimit të tyre të zgjedhur të karrierës. Njohuritë specifike që studentët pritet t'i marrin nga ky kurs përfshijnë, si në vijim: - IT qeverisjen dhe përgjegjësitë e lidershipit, si dhe se si ata kanë evoluar; - Praktikat më të mira për të dorëzuar në shkallë të gjerë sisteme dhe projekte për ndërmarrje; - Kornizat për të hartuar dhe për të vlerësuar mundësitë për e-biznes në një ndërmarrje; - Qasjet e suksesshme në përafrimin e investimeve në TI me objektivat e biznesit; - Vendimet për TI outsourcing dhe ndikimet në aftësitë për TI.

- **IT Project Management**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri për metodat, modelet, parimet, praktikat dhe sfidat që kanë të bëjnë me ciklin jetësor të projektit. Studentët do të jenë në gjendje të përkufizojnë çka është projekti, si dhe çka paraqet disiplinë në udhëheqjen e projektit. Ata do të mësojnë për konceptet e ciklit jetësor të projektit dhe sistemet për zhvillimin e këtij cikli, si dhe menaxhimi me projekte të TI dhe procesin e seleksionimit të tyre. Më pas studentët do të fitojnë njohuri për konceptimin dhe inicimin e projekteve të TI dhe menaxhimin me projekte të integruara. Përmes leksioneve do të përshkruhet organizimi formal dhe joformal i projekteve me qëllim që studentët të aftësohen për përgatitjen dhe analizën e tyre. Përmes përkufizimit dhe menaxhimit të projekteve, studentët do të njihen me fushën e menaxhimit të projekteve që bazohen në dije. Gjithashtu, studentët do të fitojnë njohuri për strukturën e shpërndarjes së detyrave dhe vlerësimin e projekteve ku do të aplikojnë mënyra të ndryshme tradicionale të vlerësimit.

- **Trende të reja në sistemet e informacionit**

Kjo lëndë do të mbulojë zhvillimin dhe trendet në sistemet e informacionit dhe ka për qëllim t'i përgatisë studentët për të qenë udhëheqës të teknologjisë duke eksploruar, analizuar dhe raportuar mbi këto tendenca dhe risi të cilat i riformojnë bizneset në shekullin e 21.

- **Biznesi elektronik dhe ai mobil**

Lënda fokusohet në infrastrukturën teknologjike të nevojshme për zbatimin e zgjidhjeve të e-biznesit, në komponentët e software-it të nevojshëm si dhe mënyrat e zbatimeve të aplikacioneve të tilla për të mirën e kompanive, duke ndjekur tendencat e reja në web dhe sistemet mobile. Një komponent i rëndësishëm i kursit do të jetë edhe projekti për zhvillimin e një aplikacioni për e-biznes.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari i përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'ua tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathësi nga kapitujt e zgjedhur të

aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxëniet si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorive dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**



Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.